



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:271366

Datë: 09.08.2024

Numri i dokumentit: 06035579

C.nr.1302/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.S, nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 2,225.75 euro, jashtë seancës, me datë 09.08.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit N.S.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditësit N.S, në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 35% të pagës bazë (421.00 euro) x 35% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 147.35 euro) = 89.03 euro x 25 muaj, t'ia paguaj shumën prej 2,225.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 04.12.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm”.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës, paditësit N.S, t'ia paguajë shumën prej 135.00 euro, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbartimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja N.S, përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datën 04.12.2023 , në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 2,225.75 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se është në marrëdhënie pune tek e paditura. Paditësit sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/33 të datës 29.08.2008, i cili ka qenë në fuqi deri më datën 06.02.2023, nuk i është llogaritur në pagë diferenca në pagë sipas vendimit të qeverisë. Andaj i ka propozuar gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta aprovojë në tërësi si të bazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 05.08.2024, ku ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditësi ka ushtruar padi në gjykatë më 04.12.2023, me të cilën kanë kërkuar kompensimin në emër të kualifikimit (licencimit) apo përqindjes në pagë, në bazë të Vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, për periudhën kohore prej 18.04.2017, e deri me datën 22.01.2021. Paditësi nuk i kanë shtjerrë të gjitha mundësitë ligjore në procedurë administrative, e që gjykata mund të shqyrtoj një padi që ka elemente nga kontesti i marrëdhënies së punës vetëm nëse paditësi i ka shtjerrë të gjitha mjetet në procedurë të rregullt pranë të paditurës si organ administrativ. Andaj e paditura konsideron se nuk ka legjitimitet real pasiv për të qenë palë në procedurë. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Për të vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të drejtë, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: kontratën e punës për mësimdhënës me numër të protokollit 851/2 e datës 27.01.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit; diplomën me numër 026/17 e datës 12.01.2017 e lëshuar nga Kolegji A, - Prishtinë; licencën e mësimdhënësit Nr. 100023242 e lëshuar më datën 29.12.2015 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për paditësen dhe listën e pagave për muajin Nëntor 2022 për paditësen.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja kishte të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Po ashtu nuk është kontestues as fakti se paditësja posedon licencë të mësimdhënësit. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditësit kompensimi nga marrëdhënia e punës në bazë të nivelit të shkollimit dhe kualifikimi, a është kërkesa e parashkruar dhe a ka legjitimitet real pasiv e paditura.

Me administrimin e kontratës së punës për mësimdhënës me numër të protokollit 851/2 e datës 27.01.2020, e lidhur ndërmjet Komunës së Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit dhe paditësit, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.S kishte të themeluar marrëdhënien e punës te e paditura, me kontratë të përhershme.

Me administrimin e diplomës me numër 026/17 e datës 12.01.2017 e lëshuar nga Kolegji A, - Prishtinë, gjykata vërtetoi faktin se paditësi N.S ka përfunduar studimet më datën 09.12.2016 dhe mori titullin Master në Kulturë Fizike dhe Sport.

Me administrimin e licencës së mësimdhënësit Nr. 1100023242 e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për paditësin N.S, gjykata vërtetoi faktin se paditësi është licencuar me licencë të mësimdhënësit nga data 29.12.2015.

Me administrimin e listës së pagave për muajin Nëntor 2022 për paditësin, gjykata vërtetoi faktin se në muajin Nëntor 2022, paditësi N.S në këtë periudhë kishte pagën bazë prej 421 euro.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1 të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4 të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditësit është dorëzuar më datën 04.12.2023, ndërsa kërkesëpadija e paditësve është për periudhën nga data 01.08.2022, e deri me datën 31.01.2023. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditësit t’i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parasheh *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Nga të lartcekurat, gjykata me rastin e vendosjes që ta aprovojë kërkesëpadinë e paditësit, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, ku është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë*

kërkesëpadinë.”. Në këtë drejtim, gjykata nga shkresat e lëndës vërtetoi gjendjen faktike, pra faktin se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe kërkesëpadinë e saj e aprovoi në tërsi pasi që është e bazuar në Kontratës Kolektive të Arsimit e Kosovës si dhe në Vendimin e Qeverisë nr.01/33, datë 29.08.2008, në këtë rast gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, duke vendosur që e paditura t’ia kompensojë të paditësit shumën si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 135,00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104,00 euro si dhe për taksën gjyqësore 31,00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1302/2023, më datë 09.08.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.

I.